



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Takim pune i Rektorit Prof.dr. Bektash Mema Universiteti "Eqrem Çabej" dhe Prof. Luciano De Bonis Universiteti i Molise - Itali .

Pas firmosjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Universitetit të Gjirokastrës dhe atij të Molise në Itali, nisin takimet e punës për konkretizimin e bashkëpunimit dypalësh.

Në datën 5 korrik 2018 në ambientet e Rektoratit të Universitetit "Eqrem Çabej" u organizua një takim pune midis Rektorit Prof.dr. Bektash Mema Universiteti i Gjirokastrës dhe Prof. Luciano De Bonis Universiteti i Molise - Itali .

Prezent në takim ishin edhe drejtuesit e Zyrave të Marrëdhënieve me Jashtë T.Todisco dhe L. Seiti si dhe Konsulli H. i Italisë në Gjirokastrë.

Fushat me interes të përbashkët për bashkëpunim akademik të shprehura në takim ishin: turizmi, trashëgimia kulturore, ekonomia , informatika , gjuha dhe kultura italiane etj , por nuk munguan edhe programet dhe projekteve evropiane si Adrion, Tempus + etj.

Dy Universitetet shprehen interes bashkëpunimi edhe për programe rajonale zhvillimi.



